



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 1238 Prot.

Vlorë, më 24/04/2026

Lënda : *Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i Sekuestros)*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Departamentit Ekonomik dhe Burimeve Mbështetëse

Drejtorisë së Aseteve dhe Burimeve Mbështetëse

Sektorit të Zgjidhjeve dhe Suportit Help Desk

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj shpalljen publike të një akti administrativ – Vendimi për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore (vendimi i sekuestros) si vijon :

- Nr.864/1 Prot., datë 10/04/2026, i materializuar për subjektin “VALONA GROUP” sh.p.k, me Nipt M56812210R, me administrator z.Antonio Moretti, me seli në Vorë (Lagjja “Kushtrimi”, Rruga “Shtjefën Gjecovi”, Objekti Nr.17”.

Jemi në pritje të konfirmimit nga ana Juaj për datën e shpalljes publike. Bashkëngjitur, gjeni kopje të aktit të lartcitur - gjithsej 2 (dy) fletë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.864/1 Prot.

Vlorë, më 10/04/2026

V E N D I M

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimit Doganor që debitori - subjekti “VALONA GROUP” sh.p.k me NUIS M56812210R, me seli në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.138, me Nr.2975/2 Prot., datë 24/12/2025, ka vendosur kontabilizimin e penalitetit doganor në shumën 50,000 (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 256/1/b të Kodit Doganor, ndaj subjektit debitor “VALONA GROUP” sh.p.k, me Nipt M56812210R me seli në VLORË (Lagjia “Kushtrimi”, Rruga “Shtjefën Gjecovi”, Objekti Nr.17), me administrator z.Antonio Moretti, me status në Q.K.B “Aktiv”.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “VALONA GROUP” sh.p.k, me Nipt M56812210R me anë të Shërbimit Postar. Gjithashtu, Dega e Doganës Vlorë ka proceduar edhe me kryerjen e lajmërimit publik të aktit administrativ, me shkresat si vijon : Nr.548 Prot., datë 20/02/2026 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit)” drejtuar Bashkisë Vlorë, e cila ka kryer konfirmimin e shpalljes publike të kryer më datë 26/02/2026; Nr.549 Prot., datë 20/02/2026 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit)” drejtuar Prefektit të Qarkut Vlorë, i cili është përgjigjur me shkresën Nr.323/1 Prot., datë 27/02/2026 me lëndë “Mbi shpalljen publike të aktit administrativ”; Nr.863 Prot., datë 25/03/2026 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit)” drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë. Më tej, Dega e Doganës Vlorë ka proceduar me shkresën Nr.864 Prot., datë 25/03/2026 me lëndë ‘Njoftim Vendimi’ dhe rezulton se zarfi me kod bar RR816220964AA është rikthyer në doganë me shënimin “I panjohur”. Vendimi administrativ i është njoftuar subjektit edhe me njoftimin elektronik të vendimit, konkretisht me email-in e datës 25/03/2026, ora 08:29, me lëndë “Rinjofitim Vendimi”.

Personi juridik debitor “VALONA GROUP” sh.p.k, me Nipt M56812210R, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr.138, me Nr.2975/2 Prot.,

datë 24/12/2025, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.138, me Nr.2975/2 Prot., datë 24/12/2025, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti "VALONA GROUP" sh.p.k, me Nipt M56812210R, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, "*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës*",

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - "VALONA GROUP" sh.p.k, me Nipt M56812210R, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - "VALONA GROUP" sh.p.k, me Nipt M56812210R, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik "VALONA GROUP" sh.p.k, me Nipt M56812210R, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të penalitetit doganor Nr.138, me Nr.2975/2 Prot., datë 24/12/2025, të Degës së Doganës Vlorë.

K R Y E T A R

Artan Bedinaj